



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/09/22

Datë: 31.03.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 21 paragrafi 21.1 pika h) të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 7 paragrafi 5 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.03.2022 nxjerrë:

V E N D I M

për

miratimin e

Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022

I. Me këtë vendim miratohet Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022 /në tekstin e mëtejme Plani/.

II. Plani është dokument publik dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

III. Kuvendi i Komunës së Junikut është i obliguar që ta respektojë dhe zbatojë Planin gjatë vitit 2022.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i miratuar nga pika I. e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Shpejtim Gacaferi



Komuna - Junik

Datë	05.04.2022
Për	Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes	Udhëheqësja e zyrës, Zyrtarja – Venera Shala
Nga	Kryesuesi i Kuvendi Komunal – Junik z. Shpejtim Gacaferi
Lejda	Lista e akteve

Bashkangjitur po ju përcjellim tabelën me akteve si dhe numrin e votave që kanë marrë në mbledhjen e kuvendit të komunës së Junikut për mbledhjen e mbajtur më **30.03.2022**

Nr	Emërtimi i aktit	Votat			Nr. i protokollit
		Për	Kundër	Abstenim	
1	Vendim për ndryshimin e planit për të hyrat vetanake të vitit 2021	15	0	0	2-180/2546
2	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2021 për shpenzim në vitin 2022	9	6	0	2-180/2547
3	Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.	9	6	0	2-180/2549
4	Vendim për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022	14	0	0	2-180/2550
5	Vendim për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar.	9	6	0	02-180/2698

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim Gacaferi

